



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS FRËNGE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Gjuhësi pragmatike dhe komunikim

Ngarkesa: 1 modul, 4 kredite, 20 orë leksione + 20 orë seminare

Viti / Semestri : Viti III, Semestri II

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Bachelor në Gjuhë Franceze 'Gjuhë dhe Komunikim '

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJE E LËNDËS DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektiva të përgjithshëm të lëndës: të njihet roli i pragmatikës, si degë e gjuhësisë, në interpretimin e kuptimit të thënieve; të përvetësohen konceptet bazë të gjuhësisë pragmatike; të njihen disa nga teoritë kryesore të pragmatikës.

Objektiva specifike të lëndës :

1. të përvetësohen konceptet *thënie konstatuese/performative* dhe *akt gjuhësor*;
2. të njihet teoria e akteve gjuhësore (Austin, Searle);
3. të njihen tipologjitë e akteve gjuhësore;
4. të njihen aktet konstitutive (formuese) dhe kushtet e realizimit të tyre;
5. të njihen aktet informuese dhe ndërveprimi bashkëveprues;
6. të përvetësohen rregullat e bisedës (sasi/cilësi/lidhje/mënyrë) dhe të fitohet aftësia e përdorimit të tyre;
7. të njihen aktet detyruese, rregullat e mirësjelljes, teoria e "faqeve";
8. të njihen aktet e tërthorta dhe mjetet gjuhësore me të cilat ato realizohen;
9. të njihet nocioni i së pathënës në gjuhë;
10. të njihen konceptet *presupozim*, *nënkuptim*, *insinuatë*, *aludim* dhe të bëhet dallimi mes tyre.